QKB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ISMET A. MAVRIQI
ADRESA Lagje "Kastrioti", Kati i Parë
TEL: 692045886

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 4542** **Nr. koleksioni: 2401**

**Fushe-kruje më 12/07/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021053410261161695

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A2021053410261161695

# KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot para meje Noter **ISMET A. MAVRIQI,** anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Fushe-Kruje, Lagje "Kastrioti", Kati i Parë, u paraqit personalisht:

**DHURUES**

**Silvana Babasi,** atësia Sami, amësia Vjollca, shtetase Shqiptare, lindur në Krujë dhe banuese në TIRANË, me adresë Johan Fon Han; Nd. 3; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 14/10/1977, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035366653 dhe nr. personal H76014036E.

**Flavio Babasi,** atësia Pëllumb, amësia Silvana, shtetas Shqiptar, lindur në Krujë dhe banues në Tiranë, me adresë Tefta Tashko; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 02/07/2000, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033522523 dhe nr. personal K00702075P.

**Semela Babasi,** atësia Pëllumb, amësia Silvana, shtetas Shqiptar, lindur në Krujë dhe banuese në Tiranë, Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 02/07/2000, gjendja civile "beqar", ID nr.personal K00702075P përfaqësuar këtu nga nëna e saj **Silvana Babasi,** atësia Sami, amësia Vjollca, shtetase Shqiptare, lindur në Krujë dhe banuese në TIRANË, me adresë Johan Fon Han; Nd. 3; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 14/10/1977, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035366653 dhe nr. personal H76014036E ***në bazë të Vendimit Nr.3616 datë 26.05.2021 lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas Nenit 231, 234 dhe 293/dh të Kodit të Familjes***.

**PRANUES I DHURIMIT**

**Ndriçim Babasi**, atësia Bajram, amësia Sabije, shtetas Shqiptar, lindur në Fushë Krujë, Krujë dhe banues në Tiranë, me adresë Donika Kastrioti; Nd. 020; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 01/01/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034813259 dhe nr. personal G70101309R.

**Rrethanat e hartimit të aktit noterial :**

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit.

Unë noteri, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

**BAZA LIGJORE**

Neni 761 e vijues të Kodit Civil

Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

A2021053410261161695

Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

**OBJEKTI**

Dhuruesit **Silvana Babasi, Flavio Babasi** dhe **Semela Babasi** janë ortakë të kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë **"BABASI COO" SH.P.K**, e regjistruar si Person Juridik me NIPT J74517209B me kapital me vlerë **327.160.000,00 Lekë** dhe numër të përgjithshëm të Kuotave **3.00** konkretisht si më poshtë :

1. **Silvana Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.
2. **Flavio Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.
3. **Semela Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.

Ortakët **Silvana Babasi, Flavio Babasi** dhe **Semela Babasi**, kanë vendosur transferimin nëpërmjet Dhurimit të Kuotave të tyre takuese si më lart që përbëjnë 3.00 Kuota ose 100 % të kapitalit me vlerë **327.160.000,00 Lekë** të zotëruar prej tyre në Shoqëri, tek Shtetasi **Z.Ndriçim Babasi**.

**OBJEKTI I KONTRATËS**

Dhuruesit **Silvana Babasi, Flavio Babasi** dhe **Semela Babasi** transferojnë nëpërmjet Dhurimit 3 Kuota ose 100 % me vlerë **327.160.000,00 Lekë** të zotëruara prej tyre në Shoqëri, tek **Z.Ndriçim Babasi**.

**GARANCITË**

Dhuruesit deklarojnë dhe garantojnë se janë të vetmit titullar të ligjshëm të kuotave që po transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Dhuruesit i dhurojnë pa asnjë kusht dhe pa kundërshpërblim Pranuesit të Dhurimit përqindjen e Kapitalit të Përshkruar më lart.

**HEQJE DORË NGA TË DREJTAT**

Dhuruesit deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre personale se heqin dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë në cilësinë e Ortakëve të Shoqërisë dhe të gjithë të drejtat dhe detyrimet për 3 kuota ose 100 % me vlerë **327.160.000,00 Lekë** të kapitalit i kalojnë Pranuesit të Dhurimit **Z.Ndriçim Babasi** me nënshkrimin e kësaj Kontrate Dhurimi, i cili i pranon ato pa asnjë kusht dhe vërejtje duke njohur dhe pranuar gjendjen juridike dhe financiare të Shoqërisë.

**TË NDRYSHME**

Pas realizimit të këtij transferimi me nënshkrimin e kësaj kontrate Pranuesi i Dhurimit **Z.Ndriçim Babasi,** bëhet pronar i vetëm i ligjshëm i 1 Kuote ose 100 % të kapitalit në Shoqëri me vlerë **327.160.000,00 Lekë,** me Vlerë në Para 291.944.499,00 në Natyrë 35.215.500,00 dhe Dhuruesit **Silvana Babasi, Flavio Babasi** dhe **Semela Babasi** largohen përfundimisht si Ortakë të kësaj Shoqërie.

Administrator i Shoqërisë për 5 vitet e ardhshme do të jetë **Ndriçim Babasi**.

Kjo kontratë u hartua në katër ekzemplar me vlera të njëjta juridike.

Kontrata e kalimit të të drejtave, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse

A2021053410261161695

ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**DHURUES**

Silvana Babasi

Silvana Babasi

**DHURUES**

Flavio Babasi

Flavio Babasi

**DHURUES**

Per Semela Babasi

Silvana Babasi

**PRANUES I DHURIMIT**

Ndriçim Babasi

Ndriçim Babasi

**NOTER**

**ISMET A. MAVRIQI**

"BABASI COO" SH.P.K

Selia : Durrës, Fushë-Krujë

Regjistruar QKB me NIPT Nr. J74517209B

**VENDIM NR.1**

**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË JASHTËZAKONSHME**

**TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

Sot me datë 09/07/2021, në Selinë e Shoqërisë, u mblodh Asambleja e Përgjithshme e jashtëzakonshme e Asamblesë se ortakëve të Shoqërisë :

Në mbledhje janë të pranishëm Ortakët :

1. **Silvana Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.
2. **Flavio Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.
3. **Semela Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.

Asambleja është thirrur rregullisht dhe është e aftë të marrë vendime të vlefshme lidhur me rendin e ditës si më poshtë vijon :

1. Miratimi i transferimit/dhurimit të kuotave të Shoqërisë nga Ortakët, tek **Z.Ndriçim Babasi,** të 100 % të kuotave të Kapitalit të zotëruar prej tyre në Shoqëri.

Meqenëse

- Shoqëria **"BABASI COO" SH.P.K** ka një prespektivë për zhvillimin e biznesit për periudhën në vazhdim Z.Ndriçim Babasi ka shprehur dëshirën për të pranuar Dhurimin e Kuotave të Shoqërisë në masën 100 % të cilat zotërohen nga ortakët sa më lart.

Asambleja mori në shqyrtim mundësinë e Dhurimit të kuotave nga Ortakët tek Z.Ndriçim Babasi.

Pas diskutimit të cështjeve Asambleja e Ortakëve miratuan me unanimitet të plotë vendimet e mëposhtme :

**VENDIMI I PARË**

Ortakët :

- **Silvana Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.
- **Flavio Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.
- **Semela Babasi** 1.00 Kuotë me Vlerë në Para 97.314.833.33, në Natyrë 11.738.500.00, në Përqindje 33.33 %.

do ti dhurojnë pjesët e tyre takuese sa më lart të kapitalit të Shoqërisë**, Z.Ndriçim Babasi.**

Asambleja e Ortakëve autorizon **Z.Ndriçim Babasi,** të kryejë të gjitha aktet dhe procedurat administrative apo ligjore për regjistrimin e këtyre ndryshimeve në QKB apo organe të tjera shtetërore.

Asambleja nuk ka cështje të tjera për të diskutuar.

Për sa u diskutua në mbledhje u lexua me zë të lartë nënshkruhet nga Ortakët e Shoqërisë personalisht.

**ORTAKËT E SHOQËRISË « BABASI COO » SH.P.K.**

| Silvana Babasi | Flavio Babasi | Për Semela Babasi |
| --- | --- | --- |
| Silvana Babasi | Flavio Babasi | Silvana Babasi |

REPUBL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | J74517209B |
| 2. Data e Regjistrimit | 09/01/1998 |
| 3. Emri i Subjektit | BABASI COO |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 05/01/1998 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 05/01/1998 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Fushe - Kruje, Km 2 i rruges nacionale Fushe - Kruje - Kruje , ndertese private, 2 kateshe |
| 8. Kapitali | 327.160.000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 3,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë i materialeve të ndërtimit, ushqimore, blegtorale, industriale, konfeksione. Prodhimin, tregtimin dhe transportimin e materialeve inerte, si: rëra, zhavorre, gurë, çakull, gëlqere, granile, dhe materialeve të ndryshme për ndërtim. Import-eksport, prodhimin e përpunimin e lëndëve plasëse e shpërthyese për përdorim civil, depozitimin dhe shitjen e tyre. Import-eksport, tranzit, transshipin, ndërmjetësimin,transferimin dhe ekspozimin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë. Import-eksport, tranzit, transshipin, ndërmjetësimin, transferimin dhe ekspozimin e mallrave dhe teknologjive të mallrave ushtarake. Import-eksport, tregtimin me shumice e pakice të naftës, benzinës, gazit dhe vajrave lubrifikante. Prodhime të blloqeve të betonit, të parafabrikateve të ndryshme. Ndërtime civile, industriale, turistike e bujqësore. Rikonstruskione të këtyre lloj ndërtimesh. Ndërtim godina banimi shumëkatëshe, ndërtim vila, pallate, rrugë. Ndërtime rrugësh dhe autostradash. |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| | Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë. Ndërtime hidraulike dhe hidroteknike, si: ujësjellës, kanalizime, kanale e impiante vaditje. Ndërtim tunelesh për rrugë automobilistike, hekurudhore dhe tunele hidroteknike për hidrocentrale. Ndërtime të veprave të veçanta, si punime nëntokësore, hidroizolime mbi dhe nëntokësore. Punime restaurimi të ndërtesave të ndryshme. Punime karpenterie, prej druri dhe metali. Punime druri dhe të nënprodukteve të tij. Punime shërbimi si pastrim, mirëmbajtje dhe zhvillim i dekorit sipërfaqesh urbane. Transport i materialeve të ndryshme civile dhe i lëndëve dhe materialeve të rrezikshme. Parkim automjetesh.Përdorimin e lëndëve plasëse e shpërthyese të përdorimit civil.Sherbime transporti te materialeve te ndryshme civile, dhe i lendeve plasese te (rrezikshme), per te tretet dhe me qera.Sherbime magazinimi te lendeve plasese e shperthyese per te tretet. Prodhimin dhe perpunimin e mermerit.Veprimtari ne fushen e agro - turizmit, mbarështimin e flores dhe faunës, peshkimit si dhe administrimit te ujrave Veprimtari ne fushen e akuakulturës dhe rekreacionit. | |
| 10. Administratori/ët | Ndriçim Babasi | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 08/02/2021 | Deri: 08/02/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | FlavioBabasi | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 97.314.833,33 | Natyre: 11.738.500,00 |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 33,33 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Ortakët | SemelaBabasi | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 97.314.833,33 | Natyre: 11.738.500,00 |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 33,33 | |

| | | |
|---|---|---|
| **Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 13.4 Komente (nëse ka) | | |
| 14. Ortakët | SilvanaBabasi | |
| 14.1 Vlera e kapitalit | Para: 97.314.833,33 | Natyre: 11.738.500,00 |
| 14.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 33,33 | |
| **Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 14.4 Komente (nëse ka) | | |
| 15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Mercedes Benz ACTROS me targe AA 387 SM<br>Vlore Himare DHERMI Drimadhe, vend ne ndërtim, zona kadastrale nr.1481<br>Durres Bubq BUDULL Ndertese private, 2 kateshe, zona kadastrale nr. 1299 me numer pasurie 390/44<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz AA 904 AD<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz KR 7093 A<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz KR 6381 A<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Gjysem Rimorkio tip Schmid me targe AER 531<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz KR 6998 A<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz KR 8096 A<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Ford AA 688 AS<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Gjysem rimorkio ADIGE KR 4887 A<br>Diber Burrel BURREL Njesia Administrative Komsi, Fshati Selixe, zona minerare 272/2, objekti Qafe Shtame<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Daimler Chrysler me targe AA 045 OV<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz KR 7648 A | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|---|---|
| | Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz AA 276 EN<br>Shkoder Shkoder SHKODER Shkoder, Njesia Administarive Postribe, fshati Mes, vendburimi Rasek , zona Minerare 2/6<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz KR 5283 A<br>Durres Kruje KRUJE Kraste, Zidoll,magazine lendesh plasese<br>Durres Kruje KRUJE Koder Kraste, Hasmuçaj, pike shitje me pakice, zona kadastrale nr. 8622, zona minerale nr. 417<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Ford KR 7519 A<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Benz AA 562 AD<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamion tip Ford AA 699 AS<br>Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Kamionçine tip Mistubishi KR 5787 A<br>Durres Kruje KRUJE Koder Kraste, Hasmuçaj, zona kadastrale nr. 8622, zona minerale nr 417 |
| 16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: BABASI COO<br>E-Mail: babasicoo@yahoo.it<br>Telefon: 0682022735 |
| 17. Statusi: | Aktiv |

Datë: 09/07/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2021/07/09 10:58:38 +02:00
J74517209B20210709105827382006



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË**
**E RRETHIT GJYQESOR**
**TIRANE**

**Nr. Regj.Them.10124**
**Dt.25.02.2021**

**Nr. 3616 Vendimi**
**Dt .26.05.2021**

**VENDIM**
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:*

**Gjyqtar: Adriatik Bocaj**

asistuar nga sekretare gjyqësore **Ramela Skuqi**, sot më datë **26.05.2021**, përfundoi së shqyrtuari, në seancë gjyqësore publike, çështjen civile me **Nr. 10124** Regj. Them. që i përket:

**KËRKUESE:Silvana Babasi**,e bija e Sami dhe Vjollca lindur dhe banuese në Tiranë më 14.10.1977 në adresen Rruga"Johana Fon Han" Nd.3,H.1 përfaqësuar nga Avokate Andia Dragoj.

**OBJEKTI:** Lëshimin e autorizimit për kërkuesen **Silvana Babasi** për tjetërsimin (shitjen)) e pjesëve takuese te aksioneve në emër të fëmijës së mitur **Semela Babasi** për kuatat ne Shoqerine **BASI COO**

**Baza Ligjore:** Neni 231, 234 dhe 293/dh të Kodit të Familjes.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të perfaqesuesit te kerkueses,i cili kerkoji pranimin e kerkese,Gjykata si dëgjoi pretendimet e palës kërkuese,pasi shqyrtoi aktet e bisedoi çështjen në tërësi;

**VËREN:**

Se kërkuesja **Silvana Babasi** ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykim kërkesën me objekt:, **L**ëshimin e autorizimit për kërkuesen **Silvana Babasi** për tjetërsimin (shitjen)) e pjesëve takuese te aksioneve në emër të fëmijës së mitur **Semela Babasi** për kuatat ne Shoqerine **BASI COO** ku femija **Semela Babasi** eshte aksioner.

Kërkuesja Lëshimin e autorizimit për kërkuesen **Silvana Babasi** për tjetërsimin (shitjen)) e pjesëve takuese te aksioneve në emër të fëmijës së mitur **Semela Babasi** për kuatat ne Shoqerine **BASI COO** kërkesën e saj e ka mbështetur në nenet 231, 234 dhe 293/dh të Kodit të Familjes *(shih objektin dhe bazën ligjore të kërkesës)*.

Nga hetimi gjyqësor (provat shkresore të administruara) si dhe shpjegimet e pales kerkuese rezulton se kerkuesia **Silvana Babasi** ka patur si bashkëshort të saj të ndjerin shtetasin **Pëllumb Babasi** dhe se nga martesa e tyre kanë lindur fëmijët **Flavio Babasi i datelindjes 02.07.2000,e Semela Babasi** e

**datelindjes 15.11.2006(shih certifikatë familjare të Silvana Babasi dhe certifikatat respektive personale të fëmijëve: Nr. 000267646, lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile, Njësia Administrative Nr.2 , më dt. 22.02.2021).**

Nga aketet del se bashkëshorti i kërkueses, i ndjeri **Pëllumb Babasi** ka ndërruar jetë më dt. 30.01.2021

Se sipas vendimit te Noteres Tirane me Nr. 122 rep dhe Nr.82 kol dt. 04.02.2021, është lëshuar dëshmia e trashigimisë për trashigimlënësin **Pëllumb Babasi** duke përcaktuar si trashigimtar ligjor të rradhës së parë të tijë bashkëshorten **Silvana Babasi** dhe fëmijët **Flavio Babasi e Semela Babasi** të cilët trashëgojnë nga 1/3 pjesë të pandarë të të gjithë pasurisë të luajtëshme dhe të paluajtëshme të trashigimlënësit kudo që ajo ndodhet.

Femija **Flavio Babasi eshte madhore.**

Fëmija i mitur **Semela Babasi** e **datelindjes 15.11.2006,** ka përfituar në rrugë trashigimie ligjore të drejta pronësie dhe është bashkëpronarë në pjesë idealë të pandarë si ortake sipas Ekstratit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me numerin e NUIS J74517209B me emer subjekti "BABASI COO" shpk eshte ortake ne kete shoqeri me pjesemarrjen ne perqindje ne capital 33,33 .

Se kërkuesja **Silvana Babasi** kërkon lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pjesëve takuese të pasurisë së paluajtshme në emër të fëmijës së saj dhe se të ardhurat e përfituara nga tjetërsimi i kësaj pasurie do t'i përdorë në interes të tije për të mundësuar përmbushjen e nevojave për arsimim dhe plotësim të kushteve të domosdoshme ekonomike, financiare, shëndetësore e sociale, cfarë është në interesin më të mirë për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Se kërkuesja **Silvana Babasi** kërkon lëshimin e autorizimit për të tjetërsuar pjesën takuese të pasurisë së paluajtshme per administrimin e kuotave te femijes **Semela Babasi** ne Shoqerine "BABASI COO" shpk ku femija **Semela Babasi** eshte aksioner ,

Gjatë gjykimit u provua se njëri prej prindërve të të miturve ka vdekur (i ndjeri **Pëllumb Babasi**), cfarë do të thotë se në rastin konkret përgjegjësia prindërore është vetëm e njërit prej tyre, konkretisht e kërkueses **Silvana Babasi.** Në këtë kuptim vullneti për të kërkuar tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme i përket kërkueses (nënës së fëmijës të mitur). Kërkuesja argumentoi para gjykatës se tjetërsimi i pjesëve takuese të të miturit në këtë bashkëpronësi është në interesin më të lartë të tije, sepse me të ardhurat e siguruara nga tjetërsimi i pasurisë së sipërcituare, ajo do t'i mundësojë fëmijës një jetesë më normale, kushtet më optimale dhe në përgjithësi kushte jetese me të mira. Nisur nga fakti se tjetërsimi i kësaj pasurie është e vetmja rrugë ligjore që do të mundësojë e krijoje kushte ekonomike, financiare, shëndetësore e sociale, arsimore duke iu krijuar kështu fëmijës së tij një përmirësim të jetesës, pasi do t'i plotësohen më mirë kushtet e mirërritjes, edukimit e sudimit, kërkohet lëshimi i këtij autorizimi.

Në përfundim të këtij gjykimi, gjykata çmon se kërkesa është e mbështetur në Nenin 234 të K. Familjes i cili parashikon se : ***"Tjetërsimi i pasurisë se paluajtshme te çdo fëmijë te mitur deri ne moshën tetëmbëdhjete vjeç, lenia hipoteke, ngarkimi me një barre, marrja hua ne emër te te miturit, heqja dore nga trashëgimia apo leku ose mospranimi i një dhurimi, si dhe përgjithësisht veprimet qe kapërcejnë kufijtë e një administrimi te thjeshte te çdo pasurie te te miturit, mund te kryhen vetëm kur e kërkon interesi i te miturit dhe me autorizim te gjykatës se vendbanimit te te miturit ".***

Gjykata krijon bindjen dhe cmon se pala kërkuese arriti të provojë se tjetërsimi i pjesëve takuese të fëmijës të saj të mitur është në interesin më të lartë të tij. Gjykata çmon se dhenia e autorizimit per administrimin e kuotave te femijes **Semela Babasi** ne Shoqerine **BASI COO** SHPK ku femija **Semela Babasi** eshte aksioner, do të siguroj të ardhura të mjaftueshme për t'i mundësuar një rritje normale, edukim e shkollim, zhvillim normal të personalitetit fëmijës, duke krijuar kushte më të favorshme të mirërritjes, edukimit e studimit, si dhe do të forcojë edhe më shumë marrëdhëniet prind - fëmijë. Kjo për faktin se të gjithë elementët e sipërpërmendur legjitimojnë interesin më të lartë të fëmijës, i cili mbizotëron në çdo proces vendimmarrjeje ku disponohet për të drejtat e femijës. Ky konkluzion gjen referim dhe në Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Për sa më lart, Gjykata çmon dhe vlerëson se kërkesa është e bazuar në ligj e në prova dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenin 234 të K. Familjes; Nenet 126, 306 e vijues të K. Pr. Civile.

**VENDOSI**

Pranimin e kërkesës se kerkueses **Silvana Babasi**;
Lëshimin e autorizimit për kërkuesen **Silvana Babasi** për tjetërsimin (shitjen) e pjesëve takuese te aksioneve në emër të fëmijës së mitur **Semela Babasi** për kuatat ne Shoqerine **BASI COO** sipas ekstratit te subjektiti me NUIS **J74517209B** , ku fëmija **Semela Babasi** eshte aksioner .

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.

**U shpall në Tiranë, sot më dt.26.05.2021**

**Sekretare**
**Ramela Skuqi**

**GJYQTAR**
**Adriatik Bocaj**

REPUBLIKA E SHQIPERISË GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

**Shpenzime gjyqësore**
**Tarife gjyqesore 200 lekë**
**Shpenzime Njoftimi 150 lekë**

Vendimi mori formë të prerë pasi nuk u ankimua më dt 21/06/2021
Tiranë më dt 28/06/2021

PULLE TARIFE

SEKRETARE
ADELA ÇINARI

REPUBLIKA E SHQIPERISË GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË